

## **Vacek: Projekti për TV dixhital, 'de fakto' monopol**

*Intervistoi Lindita Çela*

*TIRANË – Ambasadori i OSBE-së në Tiranë, Pavel Vacek, shprehet se projektligji për TV dixhital përbën monopol për një transmetues. Në një intervistë për "Shekullin", Vacek shprehet se ekspertët e OSBE-së kishin përgatitur një draft të pranueshëm në fund të dhjetorit 2004, por ky draft u ndryshua në fund të prillit. "I takon publikut shqiptar të nxjerrë përfundimin se pse ndodhi kjo", shprehet Vacek, duke shtuar se Kuvendi është informuar gjerësisht lidhur me opinionin ndërkombëtar dhe zgjedhja që duhet të bëjë është e qartë.*

**1) Parlamenti shqiptar po përgatitet që në seancën e tij të fundit të miratojë projektligjin për televizionet dixhitale në Shqipëri. Si e gjykoni këtë vendim? A mendoni se mund të miratohen ligje të tilla në kohë fushatash elektorale, kur dihet që ka vetëm një subjekt të interesuar?**

"Projektligji i miratuar nga Komisioni Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në prill përbën një shmangie nga projektligji i përgatitur me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë (OSBE, Këshilli i Evropës) në dhjetor 2004. Prezenca e OSBE-së dhe Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, së bashku me misionet e Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian dhe Zyrën Evropiane të Radiokomunikacioneve, bënë komentet e tyre për projektligjin, të cilin nuk e kemi konsideruar të mirë, dhe ua dërguam ato Kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të grupeve parlamentare më 13 maj. Unë, gjithashtu, fola për këtë çështje me kryetarin Pëllumbi, më 16 maj. Kështu, Kuvendi është informuar gjerësisht lidhur me opinionin ndërkombëtar dhe zgjedhja që duhet të bëjë është e qartë.

Unë, gjithashtu, theksoj se ne nuk kemi synuar kurrë të shkaktojmë vonesa në procesin legjislativ, i cili është ende në kohë për t'u përfunduar. Ne përgatitëm një projektligj të mirë ekspertësh, brenda dy javëve, që në dhjetor 2004. Ne e bëmë këtë gjë me kërkesë të Komisionit të Mjeteve të Informimit Publik dhe të KKRT-së – megjithatë, draft i ekspertëve u ndryshua papritur vetëm në fund të prillit. I takon publikut shqiptar të nxjerrë përfundimin se pse ndodhi kjo".

**2) A mendoni se projektligji që do të kalojë në Parlament siguron konkurrencën e lirë të operatorëve në treg apo lë shteg për monopol në këtë fushë?**

"Shqetësimi kryesor, të cilin e kemi shprehur edhe në komentet për projektligjin, të përgatitura së bashku me organizata të tjera ndërkombëtare, është se nëse projektligji i ndryshuar miratohet ashtu siç është, ai do të përbente "de facto" një monopol për një

transmetues. Kuvendi është informuar më së miri për këtë shqetësim tonin, përmes komenteve tona”.

**3) Ju është kërkuar ekspertiza juaj për këtë ligj, cili ka qenë qëndrimi juaj dhe a ju është marrë në konsideratë nga ligjvënësit?**

“Expertiza e organizatave ndërkombëtare u reflektua fillimisht në projektligjin fillestar të dhjetorit 2004. Komentet për projektligjin e ndryshuar, të cilat ne ia paraqitëm Kuvendit më 13 maj, vetëm reagonin ndaj projektligjit të ndryshuar në prill, i cili kishte ndryshuar pikat kryesore të projektligjit të ekspertëve”.